



Data: 20.06.2018

Ref.: 652/18D

Në mbështetje të; nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16.09.2010), nenit 7 dhe nenit 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 09/2017, datë: 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 56-të, të mbajtur më 11 Qershor 2018, mori:

#### V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa Nr. 595/18 H, datë: 05. 06. 2018, e Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së Nr. 466/18 i datës: 18. 05. 2018.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” ka parashtruar kërkesë Nr. 595/18 H, datë: 05. 06. 2018, për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr. 466/18 të datës: 18.05.2018, në lidhje me zgjatjen e akreditimit për programin: Administrim Biznesi (MA).

Pas shqyrtimit të kërkesës KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së për Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka”. KSHC konsideroi se gjendja faktike për Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” në kohën e marrjes së vendimit të KSHC-së është trajtuar me saktësi nga KSHC dhe në përputhje të plotë me UA për Akreditim i cili ka qenë në fuqi në momentin e marrjes së vendimit.

KSHC në mbledhjen e mbajtur më 10 Maj 2018 mori vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit institucional dhe të programeve të vlefshme të studimit për Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka”. KSHC ka marrë këtë vendim duke pasur parasysh se dinamika e AKA-së për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë është ndërprerë për 7 muaj dhe se procesi i vlerësimit të jashtëm nuk është organizuar. Vizita me ekspertë ndërkombëtar nuk është realizuar sipas afateve të parapara nga AKA dhe rrjedhimisht rrezikohet vonimi i regjistrimit të studentëve të rinj në këto programe të studimit. Po ashtu KSHC i AKA-së me qëllim që procesi i vlerësimit dhe akreditimit të mos mbi ngarkohet dhe mos dyfishohet me rastin e fillimit të procesit të ri të akreditimit kishte marrë vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit, për periudhën një vjeçare, për gjitha programet e studimit të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” të cilat kanë akreditim të vlefshëm sipas vendimeve përkatëse të KSHC-së.


Meqenëse Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" nuk ka aplikuar për riakreditim të programit të studimit: Administrim Biznesi (MA) me rastin e aplikimit për programet e tjera (Aplikacioni për akreditim, Nr. 833/17, 15. 12. 2017) dhe programi në fjalë nuk ka akreditim nga data: 1 Tetor 2018 (vendimi i KSHC, Nr. 631/15, datë:13.07. 2015), KSHC nuk ka mundur të marrë vendim për zgjatjen e akreditimit të këtij programi.

Duke pasur parasysh arsyet e cekura më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
\_\_\_\_\_  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

